



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201501357/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** Rekomandohet "Marrja e masave të menjëhershme për trajtimin mjekësor dhe vizitën në Spitalin Rajonal Krujë, të të dënuarit A. D."

**Drejtuar :** Drejtorit të Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale  
Fushë-Krujë  
Z. Arben SULOJ

**KRUJË**

I nderuar Z.SULOJ,

Në Institucionin e Avokatit të Popullit më datë 21.07.2015, ka paraqitur ankesë shtetasi i dënuar A. D., i cili ka ngritur pretendimin se vuan nga tromboza në këmbë dhe megjithë kërkesat e tij drejtuar personelit të shërbimit shëndetësor të institucionit, prej tyre nuk janë marrë masat e nevojshme për trajtim mjekësor në Spitalin Rajonal Krujë.

Në nenin 5 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve" i ndryshuar, i cili bën fjalë për Parimet Themelore, thuhet: "Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre".

Kurse në nenin 33 të ligjit të mësipërm, i ndryshuar, i cili bën fjalë për Shërbimin Mjekësor, thuhet: "Administrata e institucionit siguron kushtet, mjetet dhe personelin për mbrojtjen e shëndetit të të dënuarve".

"Organizimi dhe realizimi i shërbimit shëndetësor bëhen nga administrata e institucionit në bashkëpunim me spitalin e burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë".

Të drejtat e të dënuarve për trajtim në shërbimin shëndetësor parashikohen dhe në aktet ndërkombëtare. Kështu, në Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Jashtëm të Këshillit të Europës datë 12 Shkurt 1987 “Për Rregullat Europiane të Burgut”, ku në kapitullin që bën fjalë për Drejtimin e Sistemit të Burgjeve, Pikën 30.1 thuhet: “ Mjeku do të kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të burgosurve dhe në përputhje me kushtet e intervalet e standarteve spitalore, do të vizitojë të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që raportojnë për sëmundje, ose dëmtim dhe çdo të burgosuri t’i kushtohet një vëmëndje e veçantë”.

Kurse në Pikën 32 thuhet: “Shërbimet mjekësore të institucionit do të kërkojnë që të diagnostikojnë e kurojnë çdo sëmundje ose të metë fizike e mendore, që mund të pengojë riintegrimin e një të burgosuri pas lirimit. Për këtë qëllim, të burgosurit do t’i sigurohen të gjitha shërbimet e nevojshme mjekësore , krirugjikale dhe psihiatrike , përfshirë ato që janë në dispozicion të komunitetit”.

Për sa sipër duke gjetur se ankesa e shtetasit A. D., është e drejtë, bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike” dhe në bazë të nenit 21 gërma “b” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet:“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, paraqet rekomandime për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

## **REKOMANDOHET**

“Marrja e masave të menjëhershme për trajtim mjekësor dhe vizitë në Spitalin Rajonal Krujë të të dënuarit A. D.”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin Tuaj.*

**K O M I S I O N E R I**

Tiranë më 10.08.2015  
Konc.&.Dakt.P.A.

**Arben SHKËMBI**

